

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

08.04.2021  
Ora 14:28

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.151, datë 16.03.2021, “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**

• **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** KQZ me Vendimin nr.151 datë 16.03.2021 ka miratuar listën e vëzhguesve të misionit OSBE/ODIHR duke vendosur miratimin e 31 vëzhguesve afatgjatë. Në datën 7.04.2021 misioni OSBE/ODIHR ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për akreditimin e 1 vëzhguesi afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe emrin e vëzhguesit afatgjatë, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë miratohet edhe kjo kërkesë për të shtuar edhe një vëzhgues në listën e vëzhguesve afatgjatë, të misionit të OSBE/ODIHR. Faleminderit!

**Vendimi nr.206**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021

08.04.2021  
Ora 14:22

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të shoqërisë “Panorama group”, të portalit “Bulqiza ime”, të televizionit “Top Channel” të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press” (AP), të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), të gazetës “SOT” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve    **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:    **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**

● **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Shoqëria “Panorama group” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 13 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Portali “Bulqiza ime” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 5 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Top Channel” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 118 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Agjencia Ndërkombëtare e Lajmeve “Associated Press” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 8 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se në tabelën e paraqitur me të dhënat individuale të gazetarëve dhe

Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

operatorëve, operatori me nr.2 është akredituar në një subjekt tjetër kështu që nuk është pjesë e kësaj liste. Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH) ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 12 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gazeta “SOT” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 5 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat jo qeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuese të huaja, mediave dhe subjekteve zgjedhore”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve të çdo organizate që ka paraqitur kërkesën, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, miratojmë:

Kërkesën e “Panorama group” për akreditimin e 13 gazetarëve;

Portalit “Bulqiza ime” për akreditimin e 5 gazetarëve;

Televizionit “Top Channel” për akreditimin e 118 gazetarëve;

Agjensisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press” me 7 gazetarë;

Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATSH) për akreditimin e 12 gazetarëve;

Gazeta “SOT” për akreditimin e 5 gazetarëve.

**Vendimi nr.207**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

**08.04.2021  
Ora 14:26**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të Anadolu Agency (AA) për një shtesë në vendimin nr.176, datë 23.03.2021 për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve   Z.Illirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:   Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**

• **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Anadolu Agency (AA) ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 3 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre dhe televizioni A2 CNN ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 gazetarëve. Më parë ky television ka paraqitur kërkesë dhe është miratuar nga KQZ me Vendimin nr.117 për akreditimin e 65 gazetarëve. Kjo është shtesë në kërkesën e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve dhe gazetarëve, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Këto do t'i bëjmë me dy vendime sepse një lidhet me ndryshimin e një vendimi dhe një është kërkesë e re. Do të jenë 2 akte. Akti që miraton kërkesën e Anadolu Agency do jetë vendim më vete kurse kjo për shtesën në listën e vëzhguesve në televizionin A2 CNN është vendim tjetër apo jo? Kështu është? Po, mqs e keni vendosur ndryshim vendimi të 176.                   **Vendimi nr.208**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

**08.04.2021  
Ora 14:26**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të televizionit A2 CNN për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Anadolu Agency (AA) ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 3 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre dhe televizioni A2 CNN ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 gazetarëve. Më parë ky television ka paraqitur kërkesë dhe është miratuar nga KQZ me Vendimin nr.117 për akreditimin e 65 gazetarëve. Kjo është shtesë në kërkesën e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve dhe gazetarëve, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Këto do t'i bëjmë me dy vendime sepse një lidhet me ndryshimin e një vendimi dhe një është kërkesë e re. Do të jenë 2 akte. Akti që miraton kërkesën e Anadolu Agency do jetë vendim më vete kurse kjo për shtesën në listën e vëzhguesve në televizionin A2 CNN është vendim tjetër apo jo? Kështu është? Po, mqs e keni vendosur ndryshim vendimi të 176.

**Vendimi nr.209**

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

08.04.2021  
Ora 14:27

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të fondacionit “Së Bashku” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**

• **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Fondacioni “Së Bashku” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 16 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Ky fondacion është themeluar dhe vazhdon të drejtohet me të rinj me aftësi të kufizuar dhe objektivi për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatshkurtër, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë miratohet:

Kërkesa e fondacionit “Së Bashku” për akreditimin e 16 vëzhguesve afatshkurtër.

**Vendimi nr. 210**

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.08.04.2021*

08.04.2021  
Ora 14:28

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e përkthyesve të misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:    **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**

• **Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Misioni i OSBE/ODIHR ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për akreditimin e 29 përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. ODIHR është një prej organizatave të krijuara në kuadrin e OSBE-së, e cila që në themelimin e saj është kthyer në një organizim kryesor të monitorimit, promovimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e përkthyesve, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë miratohet:

Kërkesa e misionit OSBE/ODIHR për akreditimin e 29 përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend, të datës 25 prill 2021.

**Vendimi nr.211**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*

